

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| Nr. Rendor ¹ | Data e kërkesës ² | Objekti i kërkesës ³ | Data e përgjigjes ⁴ | Përgjigje ⁵ | Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶ | Tarifa ⁷ |
|-------------------------|------------------------------|--|--------------------------------|--|---|---------------------|
| 03 | 22.01.2024 | <p>Përkatësisht për vitet 2013-2023 sa është vlera e vënë nga buxheti i shtetit (e ndarë sipas viteve) për kompensimin financiar të ish-pronarëve?</p> <p>2. Sa është numri i dosjeve të ish-pronarëve në të gjithë Republikën e Shqipërisë të regjistruara në institucionin tuaj nga viti 2013 deri më sot?</p> <p>3. Sa është numri i ish-pronarëve të cilët janë kompensuar duke ju kthyer fizikisht pronat e</p> | 16.01.2024 | <p>Buxheti i shtetit miraton çdo vit buxhetor një fond financiar të dedikuar, sipas tabelës të paraqitur në shtojcën 2 të këtij ligji, por jo më pak se 50 miliardë lekë në 10 vjet, i cili do të administrohet nga ATP-ja për realizimin e procesit të kompensimit të pronave.</p> <p>Në këto kushte, vlera financiare e vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit për kompensimin financiar të ish-pronarëve për vitin 2016 është 2 mld lekë, për vitin 2017 është 1.5 mld lekë, për vitin 2018 është 2.5 mld lekë, për vitin 2019 është 3.08 mld lekë, për vitin 2020 është 1.9</p> | E Plote | Nuk ka |

¹ Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

² Data e regjistrimit të kërkesës

³ Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁴ Data e kthimit të përgjigjes

⁵ Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁶ Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar

⁷ Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

| | | | | | | |
|--|--|--|--|---|--|--|
| | | <p>sekuestruara nga viti 2013 deri më sot. Në këtë kërkesë të specifikohen në m² sipërfaqet e kompensuara dhe qyteti/fshati ku ndodhet sipërfaqja e kompensuar.</p> <p>4. 4. Sa është detyrimi që shteti shqiptar ka ndaj ish pronarëve në vlerë lekë nga viti 2013 deri më sot?</p> <p>5. Sa është numri i proceseve gjyqësore të depozituara ish pronarët në Gjykatën e të Drejtave të Njeriut në GJEDNJ nga viti 2013-2023? Po numri i çështjeve të fituara gjatë këtyre viteve?</p> <p>6. Sa është vlera financiare e detyrimeve të paguara nga zbatimi i vendimeve të GJEDNJ-së për ish pronarët nga viti 2013-2023?</p> <p>7. 7. Sa është vlera financiare e detyrimeve të papaguara nga zbatimi i vendimeve të GJEDNJ-së për ish pronarët nga viti 2013-2023?</p> <p>8. Si ka ndikuar Ligji 133/2015, pra ligji i ri në trajtimin e pronës? A ka përshpejtuar procesin e kompensimit fizik dhe financiar të ish pronarëve?</p> <p>9. Sipas jush në tërësi ky proces a mund të cilësohet i zvarritur ndër</p> | | <p>mld lekë, për vitin 2021 është 1 mld lekë, për vitin 2022 është 1 mld lekë dhe për vitin 2023 është 1.9 mld lekë.</p> <p>Agjencia e Trajtitimit të Pronave në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, i ndryshuar me ligjin nr.77/2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, shqyrton dhe trajton kërkesat për njohje pronësie të pa trajtuara me vendim.</p> <p>Pranë Drejtorisë së Trajtitimit të Kërkesave për Njohje Pronësie janë në proces shqyrtimi 6907 dosje dhe praktika/kërkesa të cilat që janë depozituar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, si dhe ato të paraqitura brenda afatit që ka parashikuar ky ligj, ndërsa janë regjistruar në total 2454 aplikime/kërkesa për kompensim financiar/ fizik dhe me kërkesë të veçantë.</p> <p>Deri aktualisht kanë përfituar kompensim fizik nga fondi i tokës 133 aplikime/kërkesa për kompensim me një sipërfaqe totale prej 717.81 ha në qarqet Berat, Korçë, Elbasan dhe Gjirokastrë.</p> <p>Gjithashtu ju bëjmë me dije se, nga hyrja në fuqi e ligjit të posaçëm, Agjencia e Trajtitimit të Pronave ka vlerësuar gjithsej</p> | | |
|--|--|--|--|---|--|--|

| | | | | | | |
|----|------------|---|------------|---|---------|--------|
| | | vite? Sa është mesatarisht përqindja e kompensimit për pronar në raport me pronën e regjistruar apo poseduar prej tyre? | | 26 092 vendime përfundimtare për të cilat është njohur e drejta e kompensimit ndër vite, fatura financiare e të cilëve shkon në vlerën prej 116.15 miliard lekë. | | |
| 04 | 31.01.2024 | Informacion për dosjen nr.x datë x.x.x, për kompensim financiar dhe fizik në emër të X Y | 12.02.2024 | ATP ka publikuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare regjistrin e vendimeve të cilat ju kanë njohur subjekteve të shpronësuar të drejtën e kompensimit, ku rezulton se vendimi nr. x, datë x.x.x të ish-KKKP Bashkia Kuçovë, në emër të subjektit të shpronësuar X Y figuron i publikuar dhe i vlerësuar financiarisht në shumën 3,096,293 (tre milion e nëntëdhjetë e gjashtëmijë e dyqind e nëntëdhjetë e tre lekë). Gjithashtu ju informojmë se me vendimin nr.18 (K) i Regjistrin Themeltar, datë 8.11.2023, i saktësuar me vendimin nr. 18 (K) i Regjistrin Themeltar datë 13.12.2023, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë ka vendosur “1. Pranimin e kërkesës për pezullimin e zbatimit të neneve 1, pika 2 dhe 2, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 77/2022, datë 17.11.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”. Pas shuarjes të masës të sigurimit, ATP do vijoj me trajtimin e dosjeve. | E Plote | Nuk ka |

| | | | | | | |
|----|------------|---|------------|--|---------|--------|
| 05 | 16.02.2024 | <p>Sa titullarë ka pasur institucioni në periudhën 2019-2023 dhe në cilat vite saktësisht kanë ndodhur ndërrime.</p> <p>Sa është numri i punonjësve të larguar nga institucioni për periudhën 2019-2023</p> <p>Sa është numri i punonjësve që kanë pezulluar statusin dhe (nuk) janë rikthyer përperiudhën 2019-2023</p> <p>Nëse punonjësit nuk janë rikthyer në pozicionet e mëparshme në institucion, cilat janë arsyt?</p> <p>A i identifikon vetë institucioni talentet brenda organizatës? Nëse po, cilat janë kriteret që përdoren? Nëse jo, a është diskutuar ndonjëherë kjo çështje brenda institucionit?</p> | 28.02.2024 | <p>Gjatë kësaj periudhe institucioni ka patur 2 titullarë. Nga 2017- 13.05.2022 Drejtor I Përgjithshëm ishte Jonida Baçi dhe nga 01.09.2022 e në vijim Drejtor I Përgjithshëm Geraldo Durdaj.</p> <p>Numri punonjësve të larguar për periudhën 2019-2023 në total është 96 me kërkesën e tyre.</p> <p>Në zbatim të VKM 221/2016 rekrutimi i stafit të ATP-së bëhet me “Kodin e Punës”. pra punonjësit e ATP-së nuk gëzojnë statusin e nëpunësit civil, në këto kushte nuk ka punonjës të larguar apo të rikthyer në detyrë për shkak të pezullimit të statusit të nëpunësit civil.</p> <p>Bazuar në Pikën 4 të kërkesës suaj, ju bëjmë me dije se, Agjencia e Trajtimit të Pronave (ATP) është institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë që ushtron përgjegjësinë e ngarkuar me ligjin 133/2015, i ndryshuar dhe legjislacionin në fuqi. si dhe kryen rekrutimet e stafit dhe lëvizjet në detyrë në zbatim të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, VKM nr.221/2016 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Trajtimit të Pronës”.</p> | E Plotë | Nuk ka |
|----|------------|---|------------|--|---------|--------|

| | | | | | | |
|----|------------|--|------------|--|---------|--------|
| 06 | 19.02.2024 | Kërkoj të informohem mbi buxhetin e miratuar për Agjencinë e Trajtimit të Pronave në mënyrë të detajuar të gjitha zërat të shpenzimeve korente, duke përfshirë zërat, si: shumën e të gjithë shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes, shpenzime personeli për paga, shpërblime dhe te tjera shpenzime personeli, kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore; mallra dhe shërbime te tjera; subvencionet etj nga viti 2013 deri në vitin 2023 | 22.02.2024 | <p>Në përgjigje të kërkesës po ju vëmë në dijeni mbi Buxhetin e Miratuar të Agjencisë së Trajtimit të Pronave për vitet 2013 deri në vitin 2023, për zërat shpenzime personeli për pagën, kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, mallrat dhe shërbimte e tjera, shpërblimet, subvencionet, etj., si më poshtë:</p> <p>Shpenzime page për vitet 2013-2023 janë si më poshtë:</p> <p>Viti 2013 91,000,000 lekë , Viti 2019 171,000,000 lekë, Viti 2014 91,000,000 lekë Viti 2020 166,000,000 lekë, Viti 2015 94,000,000 lekë Viti 2021 161,000,000 lekë, Viti 2016 90,000,000 lekë Viti 2022 165,900,000 lekë, Viti 2017 157,437,000 lekë Viti 2023 174,057,000 lekë, Viti 2018 171,000,000 lekë</p> <p>Shpenzime kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore për vitet 2013-2023 janë si më poshtë:</p> <p>Viti 2013 14,000,000 lekë , Viti 2019 29,000,000 lekë, Viti 2014 14,000,000 lekë Viti 2020 29,000,000 lekë, Viti 2015 15,850,000 lekë Viti 2021 29,000,000 lekë, Viti 2016 16,000,000 lekë Viti 2022 27,700,000 lekë</p> | E Plotë | Nuk ka |
|----|------------|--|------------|--|---------|--------|

| | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|
| | | | | <p>Viti 2017 31,563,000 lekë Viti 2023 29,060,000 lekë, Viti 2018 29,000,000 lekë</p> <p>Shpenzime mallra dhe shërbime të tjera për vitet 2013-2023 janë si më poshtë:</p> <p>Viti 2013 20,000,000 lekë ,Viti 2019 74,000,000 lekë, Viti 2014 20,000,000 lekë Viti 2020 67,000,000 lekë, Viti 2015 70,700,000 lekë Viti 2021 54,000,000 lekë, Viti 2016 60,500,000 lekë Viti 2022 55,400,000 lekë, Viti 2017 70,000,000 lekë Viti 2023 56,400,000 lekë, Viti 2018 70,000,000 lekë</p> <p>Transferta për Buxhetet familjare dhe individët (ndihma ekonomike dhe shpërblimi që u dha në vitin 2022) për vitet 2013-2023, janë si më poshtë:</p> <p>Viti 2013 240,000 lekë , Viti 2019 200,000 lekë, Viti 2014 30,000 lekë Viti 2020 200,000 lekë, Viti 2015 60,000 lekë Viti 2021 200,000 lekë, Viti 2016 0 lekë Viti 2022 1,622,000 lekë, Viti 2017 0 lekë Viti 2023 200,000 lekë, Viti 2018 100,000 lekë</p> <p>Konfirmojmë se ATP nuk ka përfituar subvencione për periudhën 2013 – 2023.</p> | |
|--|--|--|--|--|--|

| | | | | | | |
|----|------------|---|------------|--|---------|--------|
| 07 | 21.02.2024 | Informacion në lidhje me pronën e ndodhur në Jonufër Vlorë, për zbatimin e vendimit të GJEDNJ të vitit 2007. | 05.03.2024 | <p>Qytetari është informuar në lidhje me procedurat ligjore të ndjekura nga ATP, duke e sqaruar për çështjet ligjore në të gjitha shkallët e gjyqimit, si dhe me vendimin që secila gjykate ka marrë. Ndërsa Përsa me siper, referuar vendimeve nr.27 dhe 43 të Gjykatës Kushtetuese, Agjencia e Trajtimit të Pronave nuk ka kompetencë dhe juridiksion që të shqyrtojë ligjshmerinë e vendimeve të dhena ndër vite nga ky institucion.</p> <p>Në këto kushte, Agjencia e Trajtimit të Pronave nuk ka kompetencë dhe juridiksion administrativ dhe kompetencë që të shqyrtojë dhe të shprehet në lidhje me verifikimin e ligjshmerisë së vendimeve nr. 414 dhe nr. 415 datë 22.04.2008 të AKKP-së.</p> | E plote | Nuk ka |
| 08 | 27.02.2024 | Informacion a keni program të dedikuar për punësim në institucion dhe si është vlerësimi I punonjësve të larguar për periudhën 2019-2023? | | 1.Në Agjencinë e Trajtimit të Pronave procedurat e punësimit dhe vlerësimit të talenteve kryhen në zbatim të ligjit nr.133/2015 i ndryshuar, të ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 i ndryshuar, VKM nr. 221 datë 23.03.2016”; si dhe në respektim të vendimeve nr. 766, datë 26/12/2018, dhe nr. 812, datë 26/12/2018 të Këshillit të Ministrave procedura të zbatuara në kuadër të programit “Thirrja për Programin e Ekselencës në Institucionet e Administratës Publike” . | | |

| | | | | | | |
|--|--|--|--|---|--|--|
| | | | | <p>2.Për punonjësit e administratës së Agjencisë së Trajtimit të Pronave rekrutimi bëhet bazuar në “Kodin e Punës” pra punonjësit nuk gëzojnë statusin e “nëpunësit civil” vlerësimi I performances kryhet sipas përcaktimeve ligjore në VKM Nr. 109, datë 26.2.2014 i ndryshuar. Bazuar në dokumentet në dosjet personale të punonjësve të larguar per shkak te ligjeve rezulton se kanë masa disiplinore dhe vlerësime periodike në periudha të ndryshme të kërkuar me vullnet te lire nga vete punonjësit dhe vlerësime të kryera nga Titullarët e institucionit. Gjate kesaj periduhe vleresimi I punonjesve te larguar ne total ka 66 shume mir, 20 mire dhe 10 kenaqshem.</p> | | |
|--|--|--|--|---|--|--|